

Z. Lazer Hebaj
Shkodër

Në përgjigje të kërkesës tuaj, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, protokolluar me nr. 4256 prot., datë 05.04.2024, ju informojmë si më poshtë:

Pasi shqyrtuam dosjen tuaj të përfitimit me nr. 113888/1, konstatuam se Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me vendim caktim pensioni nr. 1189, datë 26.06.2015, ju ka caktuar pension pleqërie të plotë, me 43 vite e 11 muaj vjetërsi pune, (*bazuar në nenin 92, të Ligjit 7703/11.05.1993, periudha e plotë e sigurimit që kërkohet për burrin, në vitin 2014 është 35 vite*), me datë fillim pagese 01.04.2015 dhe masë fillestare pensioni 18.611 lekë.

Keni plotësuar kushtet për pension pleqërie, në bazë të nenit dhe ligjit të sipërcituar, me datën 23.04.2014, ndërsa marrëdhëniet financiare me punën, i keni shkëputur më datën 01.04.2015.

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës, janë marrë periudhat si më poshtë:

- 15.03.1964 – 22.07.1968 N.SH.N Rruga Ura;
- 02.08.1968 – 28.08.1970 Shërbim ushtarak;
- 17.09.1970 – 30.01.1987 N.SH.N Rruga Ura;
- 02.02.1987 - 31.05.1994 N.D Mirëmbajtje Rruga;
- 01.08.1994- 31.10.1994 N.D Mirëmbajtje Rruga;
- 01.11.1994 - 31.12.1997 N.D Riparim makinash asfaltim, Tiranë;
- 01.07.2000 - 30.11.2002 Subjekti Karl Gega;
- 01.01.2003 - 24.03.2004 Subjekti Karl Gega.

Në llogaritjen e vjetërsisë së punës nuk është marrë periudha 01.01.1998 - 30.06.2000, në Ndërmarrjen Riparim Makinash Asfaltim, Tiranë, pasi bazuar në verifikimin me nr. 11349 prot., datë 06.11.2023, të Drejtorisë së Arkivit Qendror, nuk disponohet dokumentacion i vjetërsisë në punë për këtë periudhë.

Me vendim rishqyrtim pensioni nr. 1189/1, datë 06.07.2015, DRSSH Shkodër, bazuar në nenin 33, të Ligjit nr. 7703/11.05.1993, i ndryshuar me Ligjin nr. 10070/ 5.02.2009, ka rishqyrtuar masën e pensionit tuaj, për periudhën e punës mbi moshë pensioni.

Me vendim rishqyrtim pensioni nr. 1189/2, datë 06.07.2015, DRSSH Shkodër, bazuar në vendimin nr. 1201 datë 09.12.2015, të Komisionit Qendror të Ankimit, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr.

7703/11.05.1993, i ndryshuar me Ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, ka rishqyrtuar sërish masën e pensionit tuaj, për periudhën e punës mbi moshë.

Me vendim rishqyrtim pensioni nr. 1189/3, datë 17.11.2023, DRSSH Shkodër, ka bërë rishqyrtimin e fundit, duke shtuar periudhën e punës 1.11.1994- 31.12.1997, në Ndërmarrjen Riparim Makinash Asfaltim, Tiranë, bazuar në verifikimin e datës 15.07.2015 të Drejtorisë së Arkivit Qendror Lunder.

Llogaritja e pensionit është kryer konform nenit 32, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se: *Shuma e përgjithshme e pensionit do të jetë jo më shumë se dyfishi i shumës bazë, ose 75 për qind e pagës neto mesatare të 3 vjetëve rresht të 10 vjetëve të fundit të punës të personit të siguruar, cila të jetë më e vogël.*

Duke qenë se viti i fundit i punës tuaj, është viti 2004 dhe pensioni është përcaktuar nga llogaritja e pagës neto të 3-viteve më të mira (2008-2011), në 10 vitet e fundit të punës (2004-2014), periudha e mësipërme 01.11.1994-31.12.1997, e shtuar në vjetërsi, nuk mund të ketë efekt financiar në masën e pensionit, pasi e drejta për pension, ju ka lindur në datë 23.04.2014. Ndërkohë sqarojmë se ligji i ri nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me Ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015.

Gjithashtu, masa e pensionit ka përfituar të gjitha rritjet në vite, në zbatim të VKM–ve “Për rritjen e pensioneve” dhe duke filluar nga data 01.10.2023 masa e pensionit është në vlerën 26.074 lekë në muaj, ndërsa totali i të ardhurave në pension është 28.140 lekë në muaj, (26.074 lekë masa fillestare e pensionit + 1.566 lekë shtesa sipas nenit 33 + (640+648) lekë kompensim energjie + 150 lekë kompensim buke + 350 lekë kompesim i shpenzimeve nga ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike dhe lëndëve djegëse = 29.140 lekë në muaj)

Masa e pensionit të pleqërisë, e caktuar nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Shkodër, është llogaritur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi.

Faleminderit për mirëkuptimin.